



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

PUNONJËS SOCIAL, PSIKOLOG DHE KËSHILLUES KARRIERE(OFICER I PÛRKRAHJES PËR PUNËSIM)NË QENDRËN KOMUNITARE SHUMËFUNKSIONALE, BASHKIA MALLAKASTËR

Në zbatim të ligjit nr.15, datë 13.02.2019 “Për nxitjen e punësimit”, Ligjit 146/2015 “Për punëkërkuesit”, në vijim të reformës për integrimin në tregun e punës të personave nga familje përfituese të ndihmës ekonomike, apo që kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike; ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”; Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 2.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkuqdesjes shoqërore”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 24 datë 27.04.2022 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe Delegacionit të Bashkimit Europian për Shqipërinë në projektin me objekt : Modeli i qëndrueshëm i punësimit të integruar dhe shërbimet e kujdesit social në bashkinë Mallakastër, Bashkia Mallakastër hap procedurën për tre pozicione pune si më poshtë:

- Punonjës Social
- Psikolog
- Këshillues Karriere(Oficer i Përkrahjes për Punësim)



– Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës;

Bashkia Mallakastër ,në cilësinë e Kordinatorit ka nënshkruar kontratën e grantit me autoritetin kontraktues , Delegacionin E Bashkimit Evropian në Tiranë.Sipas kësaj kontrate Bashkia me partneritet me Help –Hilfe zur Selbsthilfe dhe Qendrën Sociale Murialdo- Fier, me financimin e Bashkimit Evropian, po zbatojnë projektin model i qëndrueshëm I shërbimeve të integruara të punësimit dhe kujdesit shoqëror në Bashkinë Mallakastër. Në kuadër të Projektit Bashkia, Help dhe Q.S.Murialdo mes të tjerash duhet që të:

- Rehabilitojnë dhe vënë në përdorim një qendër komunitare shumëfunksionale, këtej e në vijim do t'i referohemi si **QKSHF**;
- Ngrënë një model të hollësishëm manaxhimi dhe strukturën e funksionimit të QKSHF;
- Zhvillimin e një plani pesë-vjeçar të ofrimit të shërbimeve pas përfundimit të Projektit dhe kryerjen e veprimtarive në QKSHF dhe terren;
- Kryejnë trajnime për stafin e QKSHF/Bashkisë dhe komunitetit përpara marrjes në dorëzim të manaxhimit të QKSHF.

Bashkia Mallakastër kërkon të punësojë 3(tre)punonjës: punonjësin social/manaxherin e rasteve, psikologun dhe këshilluesin e karrierës(oficerin e përkrahjes për punësim), të cilët do të punojnë në Qendrën Komunitare Shumëfunksionale.

Detyrat e Punonjësit Social

- *Ndërhyrje e drejtëpërdrejtë në terren (street work)* – punë në rrugë, në mjedise të hapura dhe në komunitet për dedektimin, identifikimin, hetimin dhe mbështetjen e fëmijëve të grupit të shënjestruar. Për këtë planifikon dhe është fleksibël në kohë dhe në hapësirë për grafikun e ndërhyrjeve në terren;
- Përpilon në bashkërendim me koleget plan-veprimi për cdo fëmijë dhe grupe përfituesish sipas vecorive;
- Regjistrim të plotë të të dhënave dhe dokumentacionit përkatës periodikisht për secilin përfitues të cilëve ai u ofron shërbime të programeve
- Nismon/merr pjesë në tryeza,ëorkshope për vetëdijësimin e fëmijëve dhe familjarëve përfitues në qendër dhe në takime në terren;
- Përfshihet në draftimin e projekt propozimeve dhe raporteve të punës së organizatës kundrejt donatorëve, organizatave partnere apo institucioneve shtetërore apo ndërkombëtare;
- Bashkërendon hapat e nevojshëm me kolegët për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive/ngjarjeve ditore brenda dhe jashtë qendrës
- Është përgjegjës për vullnetarët dhe praktikantët (studentë) dhe përfshirjen e tyre në eventet e qendrës;
- Kryen vizita ne komunitet për të përfshire dhe ndjekur përfituesit e programeve të atje ku banojnë.



Detyrat e Psikologut

- Realizon seanca individuale këshillimi me fëmijët rregullisht, merr djeni për problematikat e tyre, ofron asistencën sipas rastit;
- Përgatit dosje për secilin rast që ndjek mbështetur në shënimet, vëzhgimet e veta si dhe ato të kolegëve të tjerë përfshirë: mjekun, punonjësin social, juristin, manaxherin e rasteve, nga kolegë nga organizata të tjera apo institucione shtetërore;
- Koncepton, manaxhon dhe realizon aktivitete me qëllim psiko-social si dhe me synim ndreqjen e sjelljes së fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e ofruara
- Bashkëpunon me ekipin multidisiplinar në menaxhimin e rasteve individuale të fëmijëve që përfitojnë nga programet apo familjarëve të tyre;
- Përpilon planin individual ditor e javor të punës me metodologjinë përkatëse për trajtimin e rasteve;
- Referon tek Infermjeri/mjeku, juristi brenda qendrës, tek institucionet shtetërore apo organizatat partnere rastet dhe çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtje dhe trajtim të fëmijëve apo familjarë të tyre;
- Nismon, merrë pjesë në trajnime, takime, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare që mbulojnë tematika të lidhura me objektivat e përgjithshme dhe specifike të projektit;
- Është pjesëmarrëse e punës në komunitet, ëorkshop-eve dhe punës periodike në terren me përfituesit;
- Nismon/merr pjesë në tryeza për vetëdijësimin e fëmijëve dhe familjarëve përfitues në qendër dhe në komunitet.

Detyrat e Këshilluesit të Karrierës(Oficerit të Përkrahjes për Punësim)

- Kryerja e anketave të kërkesës-ofertës në tregun lokal
- Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse të punësimit në një mjedis QKSHF dhe në komunitetet locale.
- Zhvillimi i programeve të mbështetjes së punësimit duke përfshirë skemat e trajnimit në vendin e punës
- Mbështetja e krijimit të bizneseve sociale
- Planifikimi dhe organizimi aktiviteteve të projektit dhe ngjarjeve përkatëse
- Ndërlidhja me drejtoritë bashkiake, njësitë dhe institucionet shtetërore
- Mbikëqyr procedurat e përzgjedhjes së përfituesve dhe proceset e vlerësimit të nevojave
- Kryerja e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit

-Kërkesat e përgjithshme për pranimin;

- a)Të jetë shtetas shqiptar;
- b)Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c)Të ketë mbaruar arsimin e lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dh)Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

-Kërkesat e veçanta për pranim:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë Bachelor në shkenca shoqërore(punë sociale, psikologji,sociologji etj.)
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet.
3. Njohuri të mira në Programet kompjuterike.
4. Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistim si dhe aftësi të provuara të punës në grup.
5. Të ketë experience specifike në menaxhimin e rasteve.

-Dokumentacioni,Mënyra dhe Afati I Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1.Fotokopje e kartës së identitetit;
- 2.Saktësim adrese;
- 3.Certifikatë familjare;
- 4.Një kopje të jetëshkrimit(CV);
- 5.Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 6.Fotokopje të diplomës së arsimit përkatës
- 7.Raport mjeko-ligjor të aftësisë në punë.
- 8.Vërtetimi gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)
- 9.Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
- 10.Diplomë e arsimit e noterizuar
- 11.Letër motivimi

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave bëhet pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër,brenda datës 23 Qershor 2023.

-Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak;

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë ne portalin “Shërbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Mallakastër dhe stendat e informimit të publikut,listën e kandidatit që plotëson kushtet e përgjithëshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kandidati I kualifikuar ne lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohet në mënyrë elektronike/email-mesazh,për datën,vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

Kandidatët e pa kualifikuar do të njoftohen në mënyrë elektronike/email-mesazh për arsyet e moskualifikimit.

-Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi;

- ligji nr.15, datë 13.02.2019 “Për nxitjen e punësimit”,
- Ligji 146/2015 “Për punëkërkesit”, në vijim të reformës për integrimin në tregun e punës të personave nga familje përfituese të ndihmës ekonomike, apo që kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike;
- Ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

-Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve;

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit u nënshtrohet fazave të konkurimit,sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Intervistë me gojë;
- c) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

-Testi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuri të dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave . Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e intervistës me gojë

-Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për te komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

Kandidatët fitues do të renditen sipas numërit të pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njoftimi i fituesit do të shpallet pas përfundimit të afatit të ankimimit.

BASHKIA MALLAKASTËR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

LAURETA SALIAJ

JONIDA LLAKA

MERUSHE QALLIAJ

